



## **Buletini informativ nr.16 – 1 prill deri me 30 qershor 2017**

- Seanca e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Takim me shefen e Zyrës Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të EULEX-it
- Takim me shefen e Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it
- Statistikat e lëndëve
- Seanca e ardhshme e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### **Seanca e fundit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**

#### **Seanca e 34-të e Panelit, 12-14 qershor 2017**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 34-të nga data 12 deri me 14 qershor 2017. Paneli ka marrë një (1) vendim të pranueshmërisë, një (1) vendim mbi zbatimin e rekomandimeve të tij nga ana e shefes së Misionit (ShM) dhe një (1) vendim të papranueshmërisë. Paneli gjithashtu ka vendosur që t'i heq nga lista e lëndëve dy aplikacione.

Në lëndën nr. 2011-27, e cila ka të bëjë me rrethanat lidhur me vdekjen e një personi që kishte dhënë dëshmi në një lëndë penale rreth akuzave për krime lufte, Paneli ka deklaruar se ankesa është e pranueshme sipas kushteve të neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Themelore Liritë (përkatësisht të drejtën për jetë, të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues ose dënimit).

Paneli ka konstatuar në lëndën nr. [2013-21](#), Thomas Rusche kundër EULEX-it, se ShM-ja i kishte zbatuar rekomandimet vetëm pjesërisht, pasi ShM-ja nuk e ka zbatuar rekomandimin për të bërë një deklaratë ku do të pranonte se rrethanat e rastit kishin përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i atribuohen EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Sidoqoftë, Paneli ka vendosur të mbyllë shqyrtimin e kësaj lënde. Kjo lëndë ka të bëjë me përvetësimin e supozuar të pronës së ankuesit dhe si rezultat i kësaj pretendimet për shkeljet e të drejtave.

Paneli në lëndën nr. [2015-02](#), Ramadan Hamza kundër EULEX-it, ka konstatuar se ankesa ishte e papranueshme në pajtim me rregullën 25 (1) të Rregullores së punës, si dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë për sa i përket shkeljeve të supozuara të të drejtave të tij në kontekst të procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës, për të cilat Paneli nuk ka kompetencë.

Në lëndën nr. [2015-14](#), Miodrag Konic kundër EULEX-it dhe në lëndën nr. [2015-16](#), Vuleta Vostic kundër EULEX-it, Paneli ka vendosur t'i heq këto aplikacione nga lista e vet e lëndëve në përputhje me Rregullën 29 shtesë paragrafi 1(1) i Rregullores së punës:

*“Rregulla 29 shtesë. Heqja e ankesës nga lista e lëndëve*

1. Paneli mund të heq ankesën nga lista e lëndëve në cilëndo fazë të procedurës, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se:

(1) Ankuesi nuk ka qëllim të vazhdoj me ankesën e tij/saj;

Në këto raste, Paneli nuk ishte në gjendje të vendoste komunikim të duhur me ankuesit, të cilët nuk kanë arritur të përgjigjen në letrat e Panelit.

Të gjitha vendimet e Panelit janë publikuar në faqen e internetit të Panelit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, në: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu).

Aktualisht janë tridhjetë e shtatë (36) ankesa në pritje pranë Panelit.

Gjatë seancës Paneli ka mbajtur takime me znj. Marianne Fennema, shefe e Zyrës Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të EULEX-it Kosovë si dhe me znj. Katja Dominik, shefe e Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it Kosovë, të martën me datën 13 qershor 2017.

### **Takimi me znj. Marianne Fennema, shefe e Zyrës Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të EULEX-it Kosovë, e marte, 13 qershor 2017.**



Nga e majta në të djathtë: Elka Ermenkova; Guenael Mettraux; Magda Mierzewska; Anna Bednarek; John J Ryan; Noora Aarnio; Marianne Fennema; Valentina Vitali dhe Eemeli Katila.

Agjenda ka përfshirë, ndër të tjera, sfidat sa i përket burimeve njerëzore për Sekretariatit e Panelit në kontekstin e rikonfigurimit të stafit; integrimin e të drejtave të njeriut dhe çështjeve gjinore në EULEX; mandatin ekzekutiv i EULEX-it, karshi amendamenteve të ligjin nr. 03/L053 mbi Juridiksionin, përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë; nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore në kontekstin e rasteve të personave të vrarë dhe të misionit; termat e referencës së zyrës kontaktuese për drejtat e njeriut të EULEX-it; drejtësinë tranzicionale dhe çështjet që do të ngritën në Panel në kontekstin e ndërprerjes së aktiviteteve të Misionit në një të ardhme të papërcaktuar.

**Takimi me znj. Katja Dominik, shefe e Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it, e marte, 13 qershor 2017.**




Nga e majta në të djathtë: John J Ryan; Magda Mierzevska; Katja Dominik; Bernd Franke; Noora Aarnio; Anna Bednarek; Guenael Mettraux and Elka Ermenkova.

Në agjendë është përfshirë, ndër të tjera, integrimi i të drejtave të njeriut në EULEX, drejtësia tranzicionale dhe çështjet që do të ngritën në Panel në kontekstin e ndërprerjes së veprimtarisë së Misionit në një të ardhme të papërcaktuar.

**Statistika e lëndëve**

Paneli ka shqyrtuar njëqind e pesëdhjetë e pesë (155) lëndë prej se ka filluar punën e tij në qershor të vitit 2010. Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka bërë shkelje të të drejtave në njëzet e pesë (25) lëndë. Më tej është gjetur se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në njëzet e pesë (25) lëndë të tjera, të cilat ishin konsideruar të pranueshme. Katër (4) lëndë janë parashtruar në Panel që prej 1 janarit 2017 dhe tani për tani në Panel janë tridhjetë e shtatë (37) lëndë në pritje.



## **Seanca e radhës së Panelit**

Seanca e radhës së Panelit është caktuar të mbahet nga data 6 shtator deri me 8 shtator 2017.

Vizitoni faqen tonë të internetit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)



## SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PSHDNJ

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

### Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

### Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

### Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

### Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

### Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

#### Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)

[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)

### Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.